



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 965 Prot.

Tiranë, më 24. 7 2018

VENDIM Nr. 155, datë 18.07.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 18.07.2018, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të projektit "*Godinë banimi 6 kat dhe një kat nëntokë*" *Lagjia Nr.17, rruga "Hysen Kërtusha"*, pozicionuar brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit-subjekti "PAVARËSIA" sh.a. dhe relacionin për potencialin arkeologjik të zonës, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë relacionin për potencialin arkeologjik të zonës, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti i licencuar në arkeologji të hartojë konceptin e kryerjes së sondazheve arkeologjike, për zonën e zhvillimit të projektit, i cili të paraqitet për shqyrtim në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO